

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

SCEL – 11-0015

Ankuesit:

- C1. R.B., XX**
- C2. M.K., XX**
- C3. Z.D., XX**
- C4. M.G., XX**
- C5. S.K., XX**
- C6. M.B., XX dhe S.M., XX**
- C7. S.S., XX**
- C8. N.J., XX**

Kundër

E Paditura:

Agjencia Kosovare të Privatizimit, rruga Ilir Konushevc i nr. 8, Prishtinë

Kolegji nr 1 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar Kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Çerim Fazliji, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 shkurt 2013, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Ankesa e M.B. dhe e S.M. (c6) është e pranueshme. Është e bazuar derisa ata kërkojnë që I.A. të mos pranohet dy herënë listën përfundimtare, por e pabazuar derisa ata kërkojnë që punëtorët B.R., K.B., L.B., T.G. dhe V.M. duhet të fshihen nga lista përfundimtare.**
- 2. Ankesat e R.B. (C1), M.K. (C2), Z.D. (C3), M.G. (C4), S.K. (C5) dhe S.S. (C7) janë të pranueshme dhe të bazuara. Këta punëtorë do të përfshihen në listën e punëtorëve me të drejtë në një pjese të ardhurave nga privatizimi i NSH-së XX.**
- 3. Ankesa e N.J. është e pranueshme por e pabazuar.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Ankuesit janë ish-punëtorë të NSH-së XX (PRN 106) Fi 602/89 (tash e tutje: NSH) e cila është privatizuar nga e paditura.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime është shpallur me 2 prill 2011 dhe se afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS ka qenë 23 prill 2011.

Me 8 prill 2011, R.B. (**ankuesi C1**) ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfutuar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH prej 9 maj 1977 deri me qershor 1999. Ai thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e tij dhe të familjes. Ai ankohet se e vetmja arsye se emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi në bazë të etnisë, sepse ai ka qenë i nacionalitetit Serb. Ai i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ta miratoj ankesën e tij. Ai e ka dërguar një kopje të vërtetuar të librezës së punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 26 prill 2011, AKP ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar sepse ankuesi e ka dorëzuar librezën e punës e cila ishte mbyllur me 17 gusht 1999, se ai nuk ka dërguar asnjë provë për vazhdueshmërinë e punësimit të tij pas vitit 1999 dhe se ai nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor lidhur me punësimin e të tij pas vitit 1999, ai nuk ka dorëzuar asnjë provë se e ka kontaktuar drejtorinë e NSH-së. Në ankesën e tij Ankuesi thekson se ka qenë viktimë e diskriminimit, se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë lidhur me realizimin e të drejtës së tij që del nga privatizimi i NSH-së, përfshirja në listën përfundimtare të punëtorëve për marrjen e një pjesë prej 20% por pa siguruar prova. Për më tepër, Ankuesi nuk ka vërtetuar me prova ligjore se ai i ka kontaktuar autoritet kompetente të e sigurisë në Kosovë, KFOR-in apo UNMIK-un. Pastaj, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, andaj edhe nuk mund të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legjitime siç parashikohet me Rregulloren Nr 2003/13, Neni 10.4.

Me 15 prill 2011, M.K. (**ankuesi C2**) ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfutuar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH prej 19 qershor 1984 deri me qershor 1999. Ai thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e tij dhe të familjes. Ai ankohet se e vetmja arsye se emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi në bazë të etnisë, sepse ai ka qenë i nacionalitetit Serb. Ai i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ta miratoj ankesën e tij. Ai e ka dërguar një kopje të vërtetuar të librezës së punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 5 maj 2011, AKP ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për përfshirjen e tij në listën e punëtorëve me të drejta në 20 për qind, siç parashikohet me Rregulloren Nr 2003/13, Neni 10.4, pasi që ai ka dorëzuar një kopje të librezës së punës e cila ishte mbyllur në vitin 1999, se ai nuk ka qenë në punësuar në NSH në kohën e privatizimit, dhe, përveç kësaj, ai kishte filluar një punësi të ri me një punëdhënës tjetër. Pastaj, ai nuk ka dorëzuar asnjë provë për vërtetimin e punësimit të tij pas vitit 1999, se ai është diskriminuar në bazë të etnisë dhe se nuk ka qenë i regjistruar si punëtorë i NSH-së në kohën e privatizimit. Andaj, AKP propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Me 15 prill 2011, Z.D. (**ankuesi C3**) ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH prej 15 qershor 1987 deri me qershor 1999. Ai thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e tij dhe të familjes. Ai ankohet se e vetmja arsye se emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi në bazë të etnisë, sepse ai ka qenë i nacionalitetit Serb. Ai i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ta miratoj ankesën e tij. Ai e ka dërguar një kopje të vërtetuar të librezës së punës dhe një kopje të vërtetuar të vendimit mbi pushimin vjetor nr. 567 të datës 16 qershor 1998.

Në përgjigjen me shkrim të datës 5 maj 2011, AKP ka propozuar që gjykata ta refuzojë ankesa si të pabazuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë kundër listës së përkohshme në pajtim me Nenin 67.2 të Udhëzimit Administrativ 2008/6. Në bazë të Nenit 127.4 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28, palët mund ti drejtohen gjykatës vetëm pasi të janë shterur të gjitha mjetet administrative të ankesës. Andaj, AKP propozon që ankesa e Z.D. të refuzohet si e pabazuar.

Me 15 prill 2011, M.G. (**ankuesja C4**) ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesja ka punuar në NSH prej 1 shtator 1990 deri me qershor 1999. Ajo thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e saj dhe të familjes. Ajo ankohet se e vetmja arsye se emri i tij nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi në bazë të etnisë, sepse ajo është e nacionalitetit Serb. Ajo i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ta miratoj ankesën e saj. Ajo e ka dërguar një kopje të vërtetuar të librezës së punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 25 maj 2011, AKP ka propozuar që gjykata ta refuzojë ankesën si të pabazuar sepse ankuesja nuk ka parashtruar ankesë kundër listës së përkohshme pasi që në pajtim me Nenin 127.4 67.2 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28, palët e interesuara mund ti drejtohen gjykatës vetëm pasi të janë shterur të gjitha mjetet administrative të ankesës.

Me 19 prill 2011, S.K. (**ankuesi C5**) ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se përvoja e tij e punës është afërsisht 22 vite, se ka jetuar në Mitrovicë, në pjesën veriore, se nuk ka mundur të shkoi në punë rregullisht por vetëm kohë pas kohe, deri në maj 2002. Ai nuk e posedon librezën e punës, por ka një kopje të faqes së parë sepse nuk e din se ku gjendet ajo. Ai ka thënë se drejtori M.B. gjithnjë e ka bindur atë që të largohet nga kompania për shkak të etnisë së tij. Ai i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ta miratojë ankesën e tij. Ai ka dërguar një vërtetim të lëshuar nga NSH , të datës 14 shkurt 2002, një kopje të faqes së parë të librezës së punës, vendimin nr. 2 të datës 31 janar 2002 të lëshuar nga NSH , vendimin nr. 221 të datës 16 shtator 1999 të lëshuar nga NSH.

Në përgjigjen me shkrim të datës 18 maj 2011, AKP ka propozuar që gjykata ta refuzojë ankesa si të pabazuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme në pajtim me Nenin 67.2 të Udhëzimit Administrativ 2008/6, pasi që në bazë të Nenit 127.4 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28, palët e interesuara mund ti drejtohen gjykatës vetëm pasi të janë shterur të gjitha mjetet administrative të ankesës.

Me 19 prill 2011, M.B. dhe S.M. (**ankuesit C6**) kanë paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës, për shkakun se Komisioni i AKP-së ua ka njohur të drejtën për 20 për qind personave të cilët nuk kanë qenë punëtorë të NSH-së, përderisa njëri prej tyre është regjistruar dy herë në listën përfundimtare. Punëtori, I.A. është regjistruar dy herë si punëtor i NSH-së, kurse punëtorët B.R., K.B., L.B., T.G. dhe V.M. nuk kanë punuar në NSH pas muajit korrik të vitit 1999 dhe se librezat e tyre të punës janë mbyllur me kërkesë të tyre. Të gjitha të mësipërmet mund të vërtetohen në bazë të provave materiale që gjenden në Zyren Rajonale të AKP-së, ndërsa punëtorët O.F. nuk ka qenë i punësuar në NSH pas luftës. Pos kësaj, Komisioni i AKP-së nuk e ka ftuar drejtuesit e NSH-së për ti vërtetuar faktet, andaj ata propozojnë që Dhoma e Posaçme ta ftojë menaxhmentin dhe Kryetarin e Sindikatës së NSH-së në një seancë dëgjimore.

Në përgjigjen me shkrim të datës 19 maj 2011, AKP ka dorëzuar një shkresë me vërejtjet e saj të datuar me 18 maj 2011, e cila është lëshuar nga Komisioni për Rishqyrtimin e Listës së të Punëtorëve (KSHLP) të NSH-së për secilin punëtorë. në këtë shkresë – deklaratë me shkrim, ajo ka cekur si vijon: emri i punëtorit Ibrahim Aliu është përfshirë dy herë në listën përfundimtare në saje të një gabimi teknik i cili do të korrigjohet. Sa i përket punëtorëve tjerë të përmendur në ankesë, nën numrat 2 dhe 7, ata kanë dërguar një deklaratë me shkrim për secilin punëtor, në të cilën AKP thekson se lidhur me këta punëtorë, dokumentet e dërguara nga ankuesit dhe regjistri i punëtorëve nuk vërteton se punësimi i ankuesve ka përfunduar. Për më tepër, duke m pasur parasysh aktgjykimin e lëshuar nga DHPGJS në lëndën e NSH XX (SCSL-09-008) dhe të NSH-së XX (SCEL-09-0012), në të cilat DHPGJS e thotë mendimin e saj se “ *mos-paraqitja e ankuesve në punë prej qershorit 1999 e tutje nuk ka qenë në asnjë mënyre nuk i mëveshët dëshirës së tyre që ata vullnetarisht të mungojnë nga puna, por kjo ka qenë për shkak të gjendjes së sigurisë në të cilën ata janë gjendur*”. Andaj paditësit e lartpërmendur janë të kualifikuar për tu përfshirë në listën për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Sa i përket punëtorit O.F., KSHLP-ja ka biseduar me paditësin për të mbledhur informata. Ankuesi ka cekur se ai është pushuar nga puna në kohën e futjes së masave të përkohshme në NSH në virin 1996, dhe se ai ka tentuar që të kthehet në punë në NSH pas luftës, por është penguar.; Pohimet e ankuesit kanë qenë të besueshme për KSHLP-në sepse ky Komision (KSHLP) nuk ka marrë asnjë provë nga ish-menaxhmenti i NSH-së me të cilat do të vërtetohej se ankuesi nuk është pushuar nga puna për shkak të masave të përkohshme; në bazë të lartcekurave, KSHLP, vendosi, që si rezultat i provave konkrete të siguruara nga ankuesi dhe nga menaxhmenti i NSH-së, që ankuesi është me të drejta legjitime.

Me 22 prill 2011, S.S. (**ankuesja C7**) ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e NSH-së. Ankuesja ka punuar në NSH prej 21 gusht 1986 deri me qershor 1999. Ajo thekson se është penguar fizikisht që të shkojë në punë dhe se është dashur të largohet nga Prishtina nga frika për jetën e saj dhe të familjes. Ajo ankohet se e vetmja arsye se emri i saj nuk është përfshirë në listën e punëtorëve është diskriminimi në bazë të etnisë, sepse ajo ka qenë e nacionalitetit Serb. Ajo i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ta miratojë ankesën e saj. Ajo e ka dërguar një kopje të vërtetuar të librezës së punës.

Në përgjigjen me shkrim të datës 25 maj 2011, AKP ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar sepse ankuesja pos librezës së punës nuk ka siguruar ndonjë dëshmi tjetër në bazë të cilave do të vihej në përfundim vazhdimësia e punësimit të saj në NSH pas vitit 1999. Ankuesja thekson se është diskriminuar, mirëpo, nuk e ka vërtetuar këtë me ndonjë dëshmi materiale sepse nuk ka prova se ajo i ka kontaktuar forcat e sigurisë në Kosovë, Policinë e KFOR-it dhe të UINMIK-ut. Pos kësaj, ankuesja nuk ka qenë e regjistruar si punëtorë e NSH-së në kohën e privatizimit.

Me 18 prill 2011, N.J. (**ankuesi C8**) ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme kundër të paditurës duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e NSH-së. Ankuesi më tej ka cekur se kundërshtimi i tij ndaj listës së përkohshme të punëtorëve të ndërmarrjes XX në Prishtinë i është refuzuar si i pabazuar sepse ai kishte filluar një punë të re me një punëdhënës tjetër. Kopja e dorëzuar e librezës së punës tregon se angazhimi i tij me punëdhënës tjetër ishte anuluar. Përveç të sipërpërmendurave, ky informacion mund edhe të vërtetohet me Fondin për Pension invaliditet (PIO) të Malit të Zi. Ai i propozon gjykatës që ta miratojë ankesën e tij.

Në përgjigjen me shkrim të datës 31 maj 2011, AKP ka propozuar që gjykata ta refuzojë ankesa si të pabazuar sepse ankuesi ka dërguar librezën e punës e cila është mbyllur me 30 nëntor 1998 dhe , pos kësaj, ai nuk e ka vërtetuar vazhdimësinë e tij të punës pas 30 nëntorit 1998 me asnjë dokument, ai nuk ka qenë në listën e pagave të NSH-së dhe as i regjistruar si punëtor në kohën e privatizimit.

Arsyetimi ligjor:

1.

Të gjitha ankesat (C1- C8) ishin parashtruar para skadimit të afatit kohor më 23 prill 2011. Ato janë të gjitha të pranueshme.

Dështimi i ankuesve për ta kundërshtuar listën e përkohshme në pajtim me nenin 67.2 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 nuk e bën ankesën ndaj listës përfundimtare si të papranueshme.

- a. Neni 127 i Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 nuk është i zbatueshëm. Neni 127 thotë si në vijim:

“Ankimi administrativ

127.1. Ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës.

127.2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ.

127.3. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.

127.4. Palët e interesuara mund t’i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit.”

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6, në nenin 70.3 (a) dhe (b) nën titullin “Ligji në fuqi” nuk i referohet Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28, por në vend të kësaj i referohet Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, i cili nuk përmban asnjë dispozitë që përshkruan shterimin e të gjitha mjeteve administrative para shkuarjes në gjykatë.

Megjithatë, edhe nëse neni 127 i Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 do të zbatohet, ankuesit nuk do të kishin nevojë që ta kundërshtojnë listën e përkohshme para parashtrimit të ankesës ndaj listës përfundimtare. Padia e tyre nuk ka të bëjë me listën e përkohshme (e cila mund të jetë kundërshtuar), por me listën përfundimtare (ndaj së cilën nuk është e mundur asnjë mjet administrativ).

b. Për më tepër, formulimi i fjalisë së parë të nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që punëtori duhet ta kundërshtojë listën e përkohshme në mënyrë që rrjedhimisht të kualifikohet të ankohet ndaj listës përfundimtare. Fjalitë e parë e nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 thotë si në vijim:

“Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrorë ankesë në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.”

Ligji nënvizon vetëm të drejtën për të kundërshtuar, e jo obligimin.

c. Kolegji është i vetëdijshëm se obligimi për të kundërshtuar çfarëdo mangësie në listën e përkohshme i kombinuar me sanksionin, që, nëse kjo nuk bëhet, ankesa ndaj listës përfundimtare bëhet e papranueshme, do t’i ndihmonte agjencisë që ta bëjë një listë të saktë përfundimtare brenda një kohe më të shkurtër.

Obligimi për të shteruar mjetet administrative para drejtimit në gjykatë do ta parandalonte palën nga përdorimi i mjeteve juridike pa nevojë.

Procedura e së pari bërjes së listës së përkohshme dhe dhënia e shansit secilit për ta kundërshtuar një listë të tillë dhe për të paraqitur fakte dhe prova brenda 20 ditëve i ndihmon AKP-së për ta bërë listën e saktë përfundimtare pa vonesë të panevojshme. Kjo do të thotë për tu koncentruar dhe për të shpejtuar procedurën. Mbledhja e të gjitha fakteve dhe provave të nevojshme sa më shpejtë që të jetë e mundur është një mjet kyç në kontekstin procedural në të cilin shuma monetare prej 20 për qind e pjesës për secilin punëtor varet nga aktvendimi për pranim dhe refuzim.

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk e sanksionon mungesën e bashkëpunimit të punëtorit në fazën e bërjes së listës përfundimtare duke e bërë ankesën ndaj listës përfundimtare të papranueshme (njëjtë: aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme SCEL-09-0001).

2.

Ankesa e M.B. dhe S.M. është e bazuar lidhur me kundërshtimin se I.A. është pranuar dy herë në listë.

Lidhur me kundërshtimin se punëtorët B.R., K.B., L.B., T.G., V.M. dhe O.F. janë pranuar në listë është i pabazuar.

Këta punëtorë janë të kualifikuar për marrjen e pjesës prej 20% edhe pse të gjithë ata nuk kanë qenë më në listën e pagave të NSH-së në kohën e privatizimit.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, përcakton kërkesat që një punëtor duhet t'i plotësojë në mënyrë që të konsiderohet si i kualifikuar, ndërsa neni 10 përcakton procedurën për parashtrimin e ankesës pranë Dhomës së Posaçme si në vijim:

“10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilin pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.”

B.R., K.B., L.B., T.G. dhe V.M. kanë ndaluar së punuar në korrik të vitit 1999. E paditura e ka pranuar argumentin e tyre se në fund të luftës ata janë frikësuar për jetën e tyre dhe për shëndetin e tyre.

O.F. ishte larguar në vitin 1996. E paditura e ka pranuar argumentin e tij se ai ka qenë i larguar si pasojë e masave të dhunshme.

Asnjëri nga këta punëtorë nuk i ka dorëzuar tek e paditura dokumentet ose faktet e detajuara lidhur me diskriminimin e pohuar. Sidoqoftë, e paditura i ka vlerësuar arsyet për përfundimin e punës si diskriminuese.

Ankuesit M.B. dhe S.M. nuk kanë kundërshtuar se shtatë punëtorët e kanë humbur punën e tyre për shkak të diskriminimit. Ata vetëm kanë theksuar se këta shtatë punëtorë nuk kanë punuar më në NSH pas luftës dhe ata kanë ofruar dëshmi për këtë. Megjithatë, për këtë nuk ka nevojë për dëshmi sepse kjo është e pakontestueshme. Andaj nuk ka qenë e nevojshme që të ketë seancë gojore për mbledhjen e dëshmive. Nuk ka arsye të tjera për seancën gojore (neni 68.12 i Ligjit për Dhomën e Posaçme).

Sidoqoftë, edhe nëse ankuesit M.B. dhe S.M. do të kontestonin që B.R., K.B., L.B., T.G. dhe V.M. u larguan nga Kosova nga frika e arsyeshme e dhunës dhe diskriminimit dhe se O.F. e humbi punën e tij për shkak të masës diskriminuese të administratës së përkohshme, gjykata megjithatë ende do të duhet ta miratojë ankesën.

Nuk u takon punëtorëve që ta vërtetojnë diskriminimin, por i takon të paditurës që të vërtetojë se nuk ka pasur diskriminim. Barra e provave, e cila sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ishte mbi ankuesin, është zhvendosur tek e paditura sipas Ligjit Kundër Diskriminimit Nr. 2004/03.

Neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, lidhur me barrën e provave, thotë si në vijim:

“8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.”

Neni 11 i Ligjit të njëjtë thotë si në vijim:

“11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.

11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji”.

Fundi i luftës në mes të qytetarëve të kombësisë shqiptare dhe qytetarëve të kombësisë serbe, dhuna dhe diskriminimi ndaj kombësisë shqiptare para dhe gjatë luftës dhe zbrapsja e forcave ushtarake serbe kur përfundoi lufta kanë qenë të gjitha fakte të cilat kanë lejuar presupozimin se do të bëhej diskriminim ndaj minoritetit të mbetur serb. Prandaj, kjo do të bëhej barra e të paditurës për të vërtetuar se nuk ka pasur diskriminim, dhe jo barra e ankuesit për të vërtetuar se ka pasur diskriminim (neni 8.1 i Ligjit Kundër Diskriminimit, njëjtë në aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të datës 10 qershor 2011 në lëndën SCCL-09-0001). Pasi që këta ankues, të cilët të gjithë kanë punuar në NSH për më shumë se tre vite, është dashur që të largohen nga vendet përkatëse të tyre të punës në vitin 1999 për shkak të kombësisë së tyre, ata duhet të

konsiderohen sikurse kanë qenë të punësuar, të regjistruar dhe në listën e pagave në kohën e privatizimit. Andaj, ankesa e tyre është e bazuar (neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13). Rrjedhimisht, gjithashtu nuk i takon edhe O.F. që të vërtetojë se largimi i tij gjatë administratës së përkohshme ka qenë diskriminues por kjo do të ishte barra e ankuesve M.B. dhe S.M.

3.

Ankesat e ankuesve:

R.B. (C1), M.K. (C2), Z.D. (C3), M.G. (C4), S.K. (C5) dhe S.S. (C7) janë të bazuara, edhe pse ata nuk ishin më të punësuar në NSH në kohën e privatizimit.

Gjithashtu të gjithë këta ankues janë larguar nga NSH-ja në qershor të vitit 1999 ose pas qershorit të vitit 1999 sepse ata më nuk janë ndjerë të sigurt. Asnjëri nga ata nuk ka dërguar dokumente për të vërtetuar se ai/ajo në fakt është sulmuar apo diskriminuar. Asnjëri nga ata nuk ka pohuar në detaje asnjë akt të agresionit apo diskriminimit. Megjithatë, as e paditura nuk e kontestuar faktin se ata janë larguar prej vendit të tyre nga frika, as nuk ka kundërshtuar se frika e tillë pas përfundimit të luftës ishte arsyeuar për personat e kombësisë serbe. Prandaj kjo në procedurën civile mund të merret si fakt mbi të cilin mund të bazohet aktvendimi dhe nuk ka nevojë për dokumente të tjera apo prova të tjera.

Dhe madje edhe nëse e paditura do ta kontestonte diskriminimin, nuk do të ishte barra e paditësve R.B. (C1), M.K. (C2), Z.D. (C3), M.G. (C4), S.K. (C5), S.S. (C7) dhe N.J. (C8) por do të ishte barra e të paditurës për të vërtetuar se nuk ka pasur diskriminim.

4.

Ankesa e N.J.(C8) është e pabazuar.

Është e pakontestueshme se në kohën e privatizimit ai më nuk ka qenë punëtor i NSH-së. Punësimi i tij ka përfunduar në vitin 1998. Ai nuk pohon se kjo ka qenë për shkak të diskriminimit.

Taksat Gjyqësore:

Gjykata nuk i cakton shpenzimet për ankuesin pasi që Presidiumi i Gjykatës, deri në këtë datë, nuk ka nxjerrë ndonjë plan me shkrim i cili është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (neni 57, paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri me tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për caktimin e shpenzimeve.

Këshilla ligjore:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'u dërgohet edhe palëve tjera dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor nga ankuesi brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar Ankesën tek palët e tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur ankuesit i është dërguar aktgjykimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të papranueshme nëse ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

E paditura mund të parashtrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen e saj tek ankuesi dhe tek palët tjera.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e tij tek Kolegji i Apelit dhe tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk
Gjyqtar Kryesues